



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

29.07.2026



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0042000-16/26 dt. 29.07.2026

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 2, paragrafi 5, të Rregullores (MF) Nr. 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve; nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 3 paragrafi 1 dhe 5 i Rregullore Komunale Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.07.2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0041998-16/26 dt. 28.07.2026) sjell këtë:

VENDIM

Për mbështetje financiare (subvencionim) të OJQ-së “Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë

1. MIRATOHET Vendimi për mbështetje financiare për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-së “Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë.
2. OJQ-ja “Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë mbështetet me mjete financiare prej 500.00 (pesëqind) € nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere – Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në xhirollogarinë e shoqatës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL-së

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

DBF-së

DMS-së